

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME GRIPIN SEZONAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

22 Janar 2019

Informatë për media

Instituti Kombëtar po përcjell me vëmendje ecurinë epidemiologjike të gripit sezonal në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke intensifikuar punën në terren.

Nga 01 Tetori 2018 deri sot në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë raportuar gjithsej 18.736 raste të dyshimta në grip, 3.233 raste me infeksione respiratorë akute dhe 19 raste me infeksione të rënda respiratorë akute.

Rastet raportohen nga të gjitha komunat e Kosovës. Numri më i madh i rasteve raportohet nga komunat: Prishtinë, Prizren dhe Podujevë por asnjëra nuk e kalon pragun epidemik.

Gjatë javës së 02-të (07.01.2019-13.01.2019) janë raportuar 1.617 raste ILI dhe 319 raste ARI dhe 3 raste SARI.

Në laboratorët e Qendrës kombëtare të gripit – IKSHPK janë testuar gjithsej 127 mostra të dyshimta në grip, prej tyre 19 raste rezultojnë pozitive në Influncën tip A. Nga 19 raste pozitive në 3 mostra është bërë subtipizimi dhe i takojnë subtipit AH1pdm09.

Sot më 22.01.2019 nga Klinika Infektive janë raportuar dy raste vdekje me Influenca A, një prej tyre me subtipin AH1pdm09.

Pacientet kanë pasur sëmundje kronike të sistemit kardiovaskular dhe respirator dhe nuk ka qenë të vaksinuar me vaksinën e gripit sezonal.

Hospitalizimet: Në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale gjatë 24 orëve të fundit janë hospitalizuar 7 raste me Dg. Bronchopneumonia (ARI).

Instituti Kombëtar tashmë ka dhënë rekomandime të duhura profesionale, që qytetarët të kenë kujdes dhe të mos dalin gjatë në ambiente të ftohta, të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura me dendësi të madhe të njerëzve, dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina.

Ministria e Shëndetësisë tashmë ka siguruar sasi të majftueshme të vaksinave që nga 1 tetori 2018 dhe janë distribuar nga IKSHPK në çdo QKMF në Kosovë andaj qytetarët e moshuar dhe me sëmundje kronike rekomandohen që të vaksinohen.

Aktualisht situata epidemiologjike është nën kontroll sa i përket gripit sezonal, por me gjendjen aktuale klimatologjike që po mbretëron në Kosovë, ekziston mundësia e rritjes së rasteve.

FRUTHI NË KOSOVË NËN KONTROLLË

Prishtinë, 10 Janar 2019

Kosova radhitet në mesin e vendeve me përqindje të lartë të vaksinimit. Sipas statistikave zyrtare, rreth 95 për qind e fëmijëve, janë vaksinuar, sukses ky që ka parandaluar epidemitë për 10 sëmundje vaksinë preventabile.

Fruthi, është një nga sëmundjet, që falë vaksinimit, nuk kishte shënuar epidemi në Kosovë. Por, këtë vit, megjithatë

janë shënuar 94 raste raste të fruthit të diagnostikuara në laboratorët e Institutit Kombëtar. Pjesa dërmuese e rasteve të fruthit janë regjistruar në komunitetin RAE dhe fëmijët e riatdhesuar që të gjithë të pavaksinuar.

Sipas Programit të Zgjeruar të Vaksinimit, vaksinimi kundër fruthit me vaksinën MMR është i obliguar me Ligj dhe i nënshtrohen të gjithë fëmijët e moshës 12 muajshe dhe ajo 6 vjeçare me 1 dozë prej 0.5ml. Nëse fëmija nuk është vaksinuar në periudhën kohore të caktuar, prindi është i obliguar të kompletojë statusin vaksinal të fëmijës sa më parë. Përjashtim bëjnë vetëm fëmijët që për çfarëdo arsye qoftë kanë kundërrindikacion specifik për vaksinim.

Sëmundja e fruthit karakterizohet me shkallë të lartë të infektueshmërisë andaj edhe përhapja brenda territorit të caktuar është e shpejtë. Rreziku ndër-shtetëror i importimit të sëmundjes nga vendet fqinje dhe vendet e Europës është permanent pasi që sëmundja përhapet me ajër.

Viteve të fundit sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, fruthi ka "rilindur" në Evropë, ku numri i njerëzve të infektuar që nga viti 2007, është trefishuar nga shkakun se nuk janë vaksinuar me rregull. Në shumë vende të Europës janë regjistruar të sëmurë dhe të vdekur nga Fruthi.

Organizata Botërore të Shëndetësisë raporton për rritje të shkallës së sëmundshmërisë nga fruthi në Rajonin e Evropës dhe Ballkanit përfshirë edhe Maqedoninë e cila javën e kaluar ka shpallur epidemi.

Në Kosovë situata epidemiologjike me fruth është në kontrollë të plotë dhe në mbikëqyrje permanente nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. Duke qenë se jemi në stinën e ftohtë të dimrit, kur qytetarët mblidhen në dhoma të ngrohta, të paajrosura mundësia e përhapjes së fruthit rritet, por gjithnjë vetëm te fëmijët e pavaksinuar.

Aktualisht në laboratorët e Institutit Kombëtar nuk ka asnjë

rast të izoluar të fruthit.

Të gjithë ata fëmijë të vaksinuar me rregull nuk do të sëmuren nga fruthi!

Instituti Kombëtar në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë ka siguruar doza të mjaftueshme të vaksinave kundër fruthit dhe sëmundjeve tjera vaksinë preventabile. dhe po implementon masat parandaluese e kontrolluese.

Përmes aktiviteteve të veçanta, Instituti Kombëtar dhe QKMF-të bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme po tenton të gjejë të gjithë fëmijët e komunitetit RAE të cilët një numër i tyre janë regjistruar me identitet të ndryshëm në Kosovë dhe identitet tjetër kur lëvizin në vendet fqinje!

Andaj, apelojmë te të gjithë prindët të cilët për shkaqe të ndryshme nuk i kanë vaksinuar fëmijët e tyre kundër fruthit por edhe kundër sëmundjeve tjera vaksinë preventabile, të lajmërohen menjëherë në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare në komunat përkatëse për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve të tyre.

Lusim Televizionin Publik të Kosovës që këtë apel ta emitojë edhe në gjuhën serbe, turke dhe rome. Lusim të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike të publikojnë këtë apel në hapësirat e tyre.

Është izoluar rasti i parë i

gripit A në këtë sezonë

9 Janar 2019

Instituti Kombëtar po përcjell me vëmendje ecurinë epidemiologjike të gripit sezonal në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke intensifikuar punën në terren.

Nga 01 tetori deri më 9 janar 2019 në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë raportuar gjithsej 17.119 raste të dyshimta në grip, 2.9148 raste të infeksioneve respiratore akute dhe 16 raste të rënda respiratore akute).

Rastet raportohen nga të gjitha komunat e Kosovës me përjashtim të komunave me popullatë serbe.

Numër më i madh i rasteve raportohet nga komuna e Prishtinës. Prizrenit dhe Podujevës nga muaji tetor ka pasur rritje të lehtë përgjatë muajve pasues nëntor dhe dhjetor por nuk kalon pragun epidemik.

Në laboratorin e Qendrës kombëtare të gripit – IKSHPK deri më 9 janar 2019 janë testuar gjithsej 76 mostra të dyshimta në grip.

Sot më datë 09.01.2019 nga laboratori i IKSHPK-Qendra Kombëtare e Gripit është konfirmuar një rast pozitiv në Influençën A.

Instituti Kombëtar tashmë ka dhënë rekomandime të duhura profesionale, që qytetarët të kenë kujdes dhe të mos dalin gjatë në ambiente të ftohta, të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura me dendësi të madhe të njerëzve, dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina.

Aktualisht situata epidemiologjike është nën kontroll sa i përket gripit sezonal, por me gjendjen aktuale klimatologjike që po mbretëron në Kosovë, ekziston mundësia e rritjes së rasteve.